



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË SE QYTETIT KORÇE

VENDIM


Nr. // , Datë 12 / 08 / 2008

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË KORÇË TË ISH-LICEUT TË QYTETIT TË KORÇËS SOT
NDËRTESA E SHTABIT TË BRIGADËS SË KËMBËSORISË**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, Sektori i Administrimit të Pronave Publike dhe Tokës, në bazë të Ligjit Nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore" Neni 32, V. K. M. nr. 500, datë 14.08.2001 "Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore", Ligjit Nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit", dhe Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore".

VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për kalimin në pronësi të Bashkisë Korçë të pronës Shtabi i Brigadës së Këmbësorisë Korçë i njohur për qytetin e Korçës si Ish-Liceu i Korçës, i cili mban nr. rendor 452-460 në inventarin paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore publike të Bashkisë Korçë.
2. T'i kërkohet Ministrisë së Mbrojtjes dhe A. I. T. P. P. (Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike). kalimi i pronës të Repartit të Brigadës së Këmbësorisë Korçë. në pronësi të Bashkisë Korçë për ta rikthyer atë në objekt arsimor.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Sektori i Administrimit të Pronave Publike dhe Tokës.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETAR
RAIMONDA NASE